



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 52, datë 15.11.2022

**PËR LEJIMIN E KANDIDATURËS SË ZONJËS MARIANA SEMINI (TUTULANI)
NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE,
SHPALLUR NGA KUVENDI I SHQIPËRSIË NË DATËN 16.01.2022**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Sokol Binaj	Kryetar
Marsida Xhaferllari	Zëvendëskryetare
Elsa Toska	Anëtare
Anila Leka	Anëtare
Edlira Petri	Anëtare
Enton Dhimitri	Anëtar
Etien Kapo	Anëtar
Klodiana Veizi	Anëtare relatore

Asistuar nga sekretare Rovena Behaj,

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e datës 15.11.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATI: Mariana Semini (Tutulani)

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 16.01.2022.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, znj. Klodiana Veizi, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, si dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*
Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 8577/2000), Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 16.01.2022, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e plotë, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit z. Altin Binaj.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, ku rezulton kandidat, edhe znj. Marjana Semini (Tutulani).

3. Në datën 18.02.2022, KED-ja realizoi edhe procedurën e shortit manual për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjedh anëtarja znj. Klodiana Veizi, ndërsa këshilltar ligjor, z. Besmir Rrapaj dhe znj. Laureta Nezaj.

4. Në datën 21.02.2022, kandidatja Marjana Semini (Tutulani) u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike për t’u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED-së për tërheqjen e formularëve standard dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Ky njoftim u krye në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, në adresën e postës elektronike të deklaruar nga vetë kandidatja Marjana Semini (Tutulani) dhe kopje e email-it është administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në të njëjtën datë 21.02.2022, me email drejtuar KED-së, kandidatja Marjana Semini (Tutulani) ka konfirmuar marrjen dijeni të njoftimit për fillimin e procedurave të verifikimit dhe ka kërkuar shtyrjen e këtij afati, për arsye se ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë dhe ka konfirmuar disponibilitetin që do të paraqitet në datë 25.02.2022. Duke vlerësuar objektive arsyen e paraqitur është pranuar shtyrja e afatit dhe po në datë 25.02.2022, kandidatja u paraqit pranë KED-së, tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimeve e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

II. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve kushtetuese dhe ligjore

i. Shtetësisë dhe i zotësisë të plotë për të vepruar

6. Neni 7/a pika 1 shkronja "a" e ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi shtetësinë shqiptare dhe zotësinë e plotë për të vepruar.

7. Kandidatja Marjana Semini (Tutulani) rezulton me shtetësi shqiptare, të konfirmuar nga karta e identitetit me numër personal **G65413147N**. Përgjatë procedurës së verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që kësaj kandidate t'i jetë hequr apo t'i jetë kufizuar zotësia për të vepruar.

ii. Arsimi

8. Neni 125 pika 4 e Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1 shkronja "b" e ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi "arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë".

9. Kandidatja Marjana Semini (Tutulani) ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1984-1988 si "Juriste", në Universiteti i Tiranës, Fakulteti Publik Juridik. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

iii. Përvoja profesionale

10. Neni 125, pika 4 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 2 e ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi përvojën e punës prej të paktën prej 15 vjet në detyrën e gjyqtarit, prokurorit, avokatit, profesorit ose lektorit të së drejtës, nëpunësit të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës, si dhe të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

11. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se kandidatja Marjana Semini (Tutulani) ka ushtruar veprimtaritë profesionale të mëposhtme:

- a) *Pedagoge (Përgjegjëse/Drejtor), për periudhën 01.10.1997 e në vijim, pranë Shkollës së Magjistraturës.*
- b) *Pedagoge, për periudhën 28.06.1991 – 01.10.1997, pranë Fakultetit të Shkencave politike Juridike, Universiteti i Tiranë.*
- c) *Asistente Pedagoge, për periudhën 01.09.1988 – 28.06.1991, pranë Fakultetit të Shkencave politike Juridike, Universiteti i Tiranë.*

12. Në lidhje me edukimin dhe kualifikimin nga ana e kandidates është deklaruar se:

- *Shtator 1981-Korrik 1994, studion në Shkollën e Mesme "Qemal Stafa", Tiranë, ku përfundon studimet me nota maksimale.*

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike: info@ked.gov.al Numra telefonikë: +355 4 2257302

- Shtator 1984-Korrik 1988,kryen studimet për jurisprudencë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranë dhe në Korrik 1968 diplomohet "Jurist" me rezultatet maksimale.
- Nga 1993,merr titullin "Avokat".
- Shkurt 1993,merre gradën shkencore "Kandidat i Shkencave në Drejtësi".
- Korrik-Gusht 1993,specializohet për të drejtën e krahasuar në programin TEMPUS,në Universiteti i Trentos,Itali.
- Janar-Maj 1993, përzgjidhet dhe fiton Fullbright Scholarship për Senior Reseracher në Fakultetin e Drejtësisë në Virginia, USA për një kërkim shkencor në fushën e shitjes së mallrave dhe të drejtat e konsumatorit nënprespektive kushtetuese.
- Nëntor 1994,pjesëmarrëse në kurs specializimi tre javor mbi Të drejtat e Njeriut në Firenze,Itali nga Akademia e të Drejtës Evropiane.
- Nëntor 1994,merr gradën shkencore "Doktor në Drejtësi"
- Janar-Mars 1995, specializohet për të drejtat e njeriut në Universitetin e Trentos Itali mbështetur në një Program të Komitetit të Venecias.
- Mars 1999,merr titullin shkencor "Profesor i Asociuar".
- Nëntor 2009,merr titullin shkencor "Profesor".

13. Nga ana e kandidatës janë paraqitur eksperiencat e saj në veprimtari profesionale, aktivitete me natyrë gjyqësore,me natyrë jo ligjore, ndër të cilat :

- Qershor 2009-Korrik 2013,Drejtores e Shkollës së Magjistraturës.
- Tetor 2006-Qershor 2009,Përgjegjëse e Trajnimit Fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shkollën e Magjistraturës.
- Shtator 1988-Shtator 1997,emërohet pedagoge e brendshme për "Kontratat dhe detyrimet" në Fakultetin e Drejtësisë të UT.
- 2015-2016,Eksperte e Lartë e Komisionit të Reformës Ligjore në nënkomisionet që lidhen me edukimin ligjor,drejtësinë penale për të mitur dhe profesionet e lira.
- Qershor 2015-Korrik 2016. Eksperte për Projektin e USAID në trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve dhe asistent avokatëve në Dhomat Lokale Fier,Vlorë,Korcë,Shkodër,Tiranë dhe Durrës me përkrahje të CHEMONICS (Viti III).
- Shkurt 2013-Korrik 2012. Eksperte për Projektin e USAID në trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve dhe asistent avokatëve në Dhomat Lokale Fier,Vlorë dhe Durrës me përkrahje të CHEMONICS (Viti II).
- Qershor 2011-Korrik 2012, Eksperte për Projektin e USAID në trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve dhe asistent avokatëve në Dhomat Lokale Fvlorë dhe Durrës me përkrahje të CHEMONICS (Viti I).
- Korrik -14 korrik 2015, Eksperte e IFC për trajnimin e gjyqtarëve për falimentin dhe për përgatitjen e manualeve,kurrikulave dhe materialeve për botim.
- Qershor –Tetor 2014,Eksperte për përgatitjen e Projektligji për bilbilfryrësit në bashkëpunim me një ekip ndërkombëtar nga Universiteti Utrecht-it.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- Prill-Korrik 2013, Trajnere dhe eksperte në përgatitjen Manualit për falimentin në Shqipëri të botuar në Korrik 2013 dhe për organizmin e seminareve me gjyqtarët në mbarë Shqipërinë.
- 1-30 Dhjetor 2013, Eksperte e JUST/USAID për përgatitjen e Planveprimit për konsolidimin dhe forcimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë.
- Korrik-Dhjetor 2013, Eksperte e UNESCO-s dhe ACTL-së në një studim mbi legjislacionin për trashëgiminë nënujore dhe trafikimin e objekteve arkeologjike, botuar në Dhjetor 2013.
- 2012-2013, Eksperte në Projektin e Berzhit dhe Shkollën e Maagjistraturës për organizmin e shketë seminareve për çështjet tregtare dhe përgatitjen e materialeve përkatëse.
- 2006-2009, Anëtare e Komisionit të Dytë për Reformën Ligjore, krijuar nga Kryeministri për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE dhe nënkryetare e tij nga viti 2007-2009.
- 2004- 2006, Anëtare e Komisionit të Dytë për Reformën Ligjore, krijuar nga Kryeministri për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE .
- Shtator 2005-2006, Eksperte e Casala and Associates, Tiranë një projekt të pronësisë intelektuale duke dhënë kontribut në disa projekte si një trajnere në seminare me gjyqtare dhe prokurë të organizuar me Shkollën e Magjistraturës.
- 2000-2005, Eksperte e Bankës Botërore në një projekt me Justice Reform Interantional në bashkëpunim me Osgood University, Toronto Canada për përgatitjen dhe publikimin e gjashtë teksteve në fusha të ndryshme të së drejtës.
- Prill-Dhjetor 2004, Eksperte për përgatitjen e Manualit të Ligjit të falimentimit shqiptar.
- Prill 2004-2006, Eksperte e ECO në përgatitjen e Analizës Gap Institucionel në Ministrinë e linjës etj

iv. VERIFIKIMI I FUNKSIONEVE POLITIKE

12. Neni 125, pika 5 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1 shkronja “c” i ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë dhjetë viteve të fundit nga data e kandidimit.

13. Kandidatja ka kandiduar në datën 14.02.2022. Për pasojë, verifikimi është realizuar për periudhën 10 vjeçare “14.02.2012 –14.02.2022”.

14. Sa i takon *pozicioneve drejtuese në partitë politike*, KED në datën 23.03.2022 dhe 30.03.2022 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Duhet evidentuar fakti se pjesa më e madhe e partive politike nuk kanë kthyer përgjigje. Kanë kthyer përgjigje gjithsej 5 parti politike, të cilat konfirmojnë në thelb se “*duke filluar nga viti 2012 kandidati nuk ka mbajtur funksione drejtuese apo të ketë qenë anëtare partie*”.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

15. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 2, datë 23.02.2022, vendosi “*Miratimin e formularit të vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*”. Ky vendim hyri në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 33, datë 01.03.2022. Në vijim, në datë 30.03.2022 është njoftuar me e-mail kandidatja të paraqes këtë formular të plotësuar, jo më vonë se 3 ditë nga marrja e këtij njoftimi. Kandidatja në datë 31.03.2022 ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike.

v. VERIFIKIMI I INTEGRITETIT

16. Neni 125, pika 5 i Kushtetutës parashikon se kritere të tjera për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Neni 7/a pika 1 shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë kushtet e kandidimit që kandidati: “ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale” dhe “d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi”. Neni 236 i ligjit nr. 115/2015 dhe ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 138/2015), përcaktojnë që kandidati duhet të mos jetë i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të mos ketë pasur masë sigurimi personal ose urdhër dëbimi, për një listë veprash penale të parashikuara shprehimisht nga ligji. Ndërsa neni 29 i ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” përcakton si kusht ndalues kandidimi nëse kandidati ka qenë ose jo person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, bashkëpunëtor aktiv i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe nëse figuron ose jo në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

17. Lidhur me verifikimin e të dhënave të dekriminalizimit, KED, në bazë të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikës 82 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, me shkresën nr. 218 prot., datë 07.03.2022 dhe shkresën nr. 404, datë 30.03.2022, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja Marjana Semini (Tutulani) sipas ligjit nr. 138/2015.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 331/2 prot., datë 09.03.2022, ka bërë me dije Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se “*Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacion dhe dokumente të plota nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, sipas objektivit të veprimtarisë së tyre, lidhur me të dhënat që disponojnë për secilin kandidat. Ky informacion do t’iu vihet në dispozicion sa më shpejtë të jetë e mundur.*

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruarara në formularin e plotësuar nga subjekti i këtij ligji, bazuar në kërkesën e bërë brenda 5 ditëve nga organi kompetente:

- mbi bazën e një kërkesë, ose kryesisht kur disponon të dhëna apo fakte
- kur ka informacion dhe është e nevojshme, që verifikimi të kryhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

....Në kushtet e sipërcituara të ligjit, Prokuroria e Përgjithshme, ju kërkon plotësimin e të metave të kërkesës suaj, brenda 15 ditëve nga marrja e kësaj kërkesë, për të mos u bërë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

pengesë për kryerjen e procesit të verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe të ligjit nr. 115/2016.

...Gjithashtu ju bëjmë me dije se nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të krijuar për këtë qëllim në Prokurorinë e Përgjithshme, rezultoi që:

Për personin Marjana Semini, kandidatë për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 15.11.2021, nuk është kryer ndonjë proces verifikimi në zbatim të ligjit nr. 138/2015”.

19. Prokuroria e Përgjithshme, në vijim, me shkresën nr. 331/41 prot., datë 08.04.2022, ka kthyer përgjigje, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke bërë me dije në lidhje me informacionin e marrë nga Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe nuk rezultojnë të dhëna për kandidaten Marjana Semini (Tutulani).

20. Prokuroria e Përgjithshme, në vijim, me shkresën nr. 669/1 prot., datë 06.04.2022, ka kthyer përgjigje, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke bërë me dije se: “Për kandidaten Marjana Thoma Semini (Tutulani), nga verifikimet e Zyrës së Protokoll – Arkivës dhe në sistemin IMPRO, nuk disponojmë të dhëna”.

21. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. 470 prot., datë 31.05.2022, ka kërkuar informacion nga Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), me qëllim verifikimin e figurës dhe integritetit të kandidates Marjana Semini (Tutulani).

22. Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), me shkresën nr. 4673/1 prot., datë 06.06.2022, ka kthyer përgjigje, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke bërë me dije se: “Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale, nuk rezultoi që në emër të Marjana Thoma Semini (Tutulani), të jetë regjistruar ndonjë procedim penal”.

23. Gjithashtu, për verifikimin e integritetit, të lidhur me pastërtinë e figurës dhe të gjendjes gjyqësore të kandidatit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, KED i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr. 267 prot., datë 09.03.2022); me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr. 268 prot., datë 09.03.2022); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (shkresa nr. 303 prot., datë 16.03.2022); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (shkresa nr. 247 prot., datë 09.03.2022).

24. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 1097 prot., datë 11.04.2022, është përgjigjur se: “në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 89 germat “a” dhe “c” për integritetin e figurës së zj. Marjana Semini (Tutulani)”.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

25. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje, me shkresën nr. 492/1 prot., datë 30.03.2022, nga ku rezulton se në lidhje me kandidatet Marjana Semini (Tutulani): *“nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale dhe as lidhje të personave me precedent kriminal”*.

26. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 303 prot., datë 16.03.2022, është përgjigjur se: *“rezulton e padënuar nga gjykata penale Shqiptare”*.

27. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 2540/1 prot., datë 23.03.2022, është përgjigjur se: *“shtetasja Marjana Semini, më datë 17.11.1990, me anë të martesës ka ndryshuar në përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e mbiemrit nga Tutulani në Semini”*.

28. Lidhur me *masat disiplinore*, KED vlerësoi t'i drejtohet me kërkesë për informacion institucioneve mbështetur në të dhënat në dosjen e kandidimit lidhur me funksionin publik dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (*shkresa nr. 405 prot., datë 30.03.2022*); Shkolla e Magjistraturës (*shkresa nr. 406 prot., datë 30.03.2022*). Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (*shkresa nr. 295/2 prot., datë 05.04.2022*); Shkolla e Magjistraturës (*shkresa nr. 275/1 prot., datë 07.04.2022*). Në përmbajtje të përgjigjeve, këto institucione konfirmojnë se periudha e punësimit e deklaruar nga kandidatja është e saktë, ka deklaruar pozicionet e punës konkrete, si dhe kandidatja nuk ka marrë apo ka masa disiplinore në fuqi.

29. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 217 prot., datë 07.03.2022, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Marjana Semini (Tutulani) për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

30. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 362/3 prot., datë 17.03.2022, ka dërguar vendimin nr. 66, datë 15.03.2022 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Marjana Semini (Tutulani), duke ardhur përfundimet se: *“për zonjën Marjana Semini (Tutulani), nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish- Sigurimi i Shtetit; nuk figuron të ketë materiale në dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*.

vi. VERIFIKIMI I PASURISË

31. Neni 125 pika 5 i Kushtetutës parashikon se kritere të tjera për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Neni 7/a pika 1 shkronja “dh” e ligjit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi kalimin me sukses nga kandidati të procesit të kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

32. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 219 prot., datë 07.03.2022, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr. 115/2016.

33. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Marjana Semini (Tutulani), ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

34. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 1069/3 prot., datë 12.05.2022, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Aktin Përfundimtar nr. 730/25, datë 12.05.2022 dhe rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Marjana Semini (Tutulani), ku në përfundim të analizës së hollësishme financiare konkludon se:

- a) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
- b) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.*
- c) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
- d) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

35. Nga verifikimi i Aktit Përfundimtar nr. 730/25, datë 12.05.2022, rezulton se kandidatja është paraqitur pranë ILDKPKI, ka dhënë shpjegimet dhe paraqitur dokumentacion provues shtesë në lidhje me shpjegimet e kërkuara nga ILDKPKI.

36-Rezulton të ketë një korrespondencë të shkëmbyer midis KED dhe ILDKPKI, me shkresën nr. 545, datë 29.07.2022 të cilës i mungon konfirmimi i relatorit, sikundër pika 20/1 e Vendimit Nr.4, datë 11.03.2019 të KED ka parashikuar.

Në shkresën e sipërcituar janë kërkuar sqarime shtesë nga ILDKPKI në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë së kandidatës. Rezultatet e të tillë veprimi procedural, duke qënë se nuk ka qënë i autorizuar nga relatori, janë jo të përdorshme, në këtë procedurë verifikimi të kësaj kandidateje. Gjithsesi përgjigja e kthyer nga ILDKPKI në lidhje me sqarimet e kërkuara me shkresën e sipërcituar, është e tillë që përmban argumenta ligjore dhe ekonomike, shtesë, në favor të konkluzionit të arritur prej organit të ngarkuar me ligj për të bërë verifikimin e pasurisë dhe të interesave private të subjekteve përkatëse, sa i takon deklaramit të bërë nga kjo kandidate, duke konfirmuar edhe njëherë konkluzionin e arritur në Aktin Përfundimtar nr. 730/25, datë 12.05.2022 lidhur me rezultatet e kontrollit të ushtruar për pasurinë dhe konfliktin e interesit për kandidaten Marjana Semini (Tutulani). Konkretisht:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

-Në lidhje me pasurinë Apartament me nr. 5/226, me sipërfaqe 151 m², lerë me kontratën e shitjes nr. 7976 rep., nr. 3764 kol., datë 24.10.2007, është konkluduar se nga ILDKPKI se kandidatja dhe bashkëshorti i saj, kanë patur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie, duke u vërtetuar kryerja e veprimeve nëpërmjet sistemit bankar, transferime nga depozita fillëstare, si dhe kreditime në mbërritje në mënyrë të periodike, të mbështetura me dokumentacion ligjor justifikues;

-Në lidhje me pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 50 m² të blerë me kontratë sipërmarrje nr.3604 rep, nr.357 kol, datë 09.10.2003, për të cilën nga ana e kandidatit është paraqitur dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit, konkretisht të ardhurat nga puna dhe dhurimin e bërë nga prindërit, duke u mbështetur dhurimi i bërë nga dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me punësimin e prindërve dhe të ardhurat e përfituara prej tyre.

-Në lidhje me pasurinë apartament me sip.89 m², blerë me kontratën e shitjes nr.8243 rep, nr.1967 kol, datë 24.1.1998 me vlerë 1.900.000 lekë, për të cilin është paraqitur dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me burimin e krijimit, kursimet nga bursta, të ardhurat nga puna e saj dhe bashkëshortit.

-Hetimit i është nënshtruar nga ILDKPKI edhe pasuria e llojit apartament (duplex) me sipërfaqe 140 m² blerë me kontratë sipërmarrje nr.1349 rep, nr.140 kol, datë 26.04.2003, legalizimi i të cilës është bërë në vitin 2011 dhe regjistrimi i saj është bërë në vitin 2012, si pasuria me nr.14/223, ZK 3101, e llojit truall + godinë 2 katëshe, duke konkluduar në burime të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

-Është analizuar çështja e konfliktit të interesit në lidhje me ekspertizën e kryer nga ana e kandidatës për nevoja të gjyqimit në Dhomën e Arbitrazhit Ndërkombëtar Vjenë, për të cilën nevojitej hapja e një numër NIPTI për efekt të kryerjes së pagesës. Kandidatja është rregjistruar në QKB si person fizik me NIPT M12309020Q, me objekt të veprimtarisë “eksperte në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për studime, trajnime, draftime në fushat e ligjit”. Me realizimin e ekspertizës është cregjistruar nga QKB. Në përputhje me Rregulloren e Shkollës së Magjistraturës, kjo është një veprimtari që lejohet të kryhet nga pedagogët e Shkollës, duke mos u evidentuar nga ILDKPKI, si organ përgjegjës probleme në lidhje me konfliktin e interesit.

37. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësisht të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatës Marjana Semini (Tutulani). Konkretisht KED në datat 09.03.2022, 30.03.2022, 31.05.2022, datë 07.06.2022 dhe datë 29.06.2022, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka OTP, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike: *info@ked.gov.al* Numra telefonikë: *+355 4 2257302*

- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sh.p.k, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Tirana Factoring & Lease, (15) Tranzit sha, (16) Union Financiar Tiranë, (17) Agrokredit sh.a..
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal, (9) ABI INVEST, (10) ALBSIG INVEST, (11).
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M. Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

38. Në përgjigje të kërkesave për informacion, institucionet publike dhe subjektet private të listuara më sipër, (përveç Banka Ndërkombëtare Tregtare dhe Banka e Kreditit të Shqipërisë¹) kanë dërguar përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin. Nga ana e ASHK-së në përgjigje të kërkesës së përsëritur për dërgim informacioni nr. 498 prot. datë 29.06.2022, kanë kthyer përgjigje ASHK-ë e mbetura, në datë 15.08.2022 (regjistruar në KED në datë 22.08.2022) ka kthyer përgjigje ASHK Drejtoria Vendore Vlorë (rezulton që kandidati nuk ka pasuri të regjistruar), në datë 24.08.2022 (regjistruar në KED në datë 26.08.2022) ka kthyer përgjigje ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastër (rezulton që kandidati nuk ka pasuri të regjistruar) në datë 14.09.2022 (regjistruar në KED në datë 16.09.2022) ka kthyer përgjigje ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug, duke i bashkëlidhur dokumentacionin përkatës, në datë 20.09.2022 ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastër, i ka përcjellë KED me shkresë njoftimin për kryerjen e pagesës lidhur me shërbimet kadastrale muaji gusht 2022. Nga përgjigjet e administruara rezulton se nuk ka informacione shtesë për pasuritë dhe interesat private dhe ato përputhen me ato të ILDKPKI-së.

39. Nga ana e kandidatës është bërë dhe një kërkesë e shkruar për përjashtimin e këshilltarit B.Rrapaj nga marrja pjesë në procedurat e metejshme të verifikimit të saj, kërkesë e cila është marrë në shqyrtim nga ana e Kryetarit të KED.

Në të mirë të mbarëvajtjes së procesit në vijim, kryerja e veprimeve të metejshme në idhje me procedurën e verifikimit dhe vlerësimit të kësaj kandidateje është asistuar nga këshilltarja L. Nezaj, e cila është një nga dy këshilltarët e shortuar për këtë vakancë.

III. Njoftimet dhe paraqitja e relacionit për Mbledhjen e KED

40. Në datën 31.10.2022 është përgatitur relacioni që përshkruan procedurën e zhvilluar, që shoqërohet edhe nga projekt-akti për përfundimin e procedurës së kandidimit të kandidatës Marjana Semini (Tutulani) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 16.01.2022. Këto akte i paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje mbledhjes së KED-së.

¹ Banke, e cila është në proces likuidimi.

41. Gjithashtu, pas komunikimit me kryetarin e KED-së dhe caktimit të mbledhjes, kandidates Marjana Semini (Tutulani) i njoftohet në rrugë elektronike koha e zhvillimit të mbledhjes, duke i dërguar edhe kopje e këtij relacioni. Njoftimi i tij kryhet në zbatim të pikës 34 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, duke administruar një kopje të njoftimit në dosjen e kandidatit.

42. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materialet të çështjes, i dërgohen edhe Avokatit të Popullit. Kopje e këtij njoftimi administrohet gjithashtu në dosjen e kandidatit.

43. Koha e zhvillimit të mbledhjes, rendi i ditës dhe relacioni i përgatitur për kandidaten Marjana Semini (Tutulani) i njoftohen edhe subjekteve, të cilët sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e KED-së. Edhe kopjet e këtyre njoftimeve administrohen në dosjen e kandidatit.

44. Gjithashtu, dita dhe ora e zhvillimit të mbledhjes së KED-së, si dhe rendi i ditës publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

I. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

45. KED, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidates, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidates Mariana Semini (Tutulani) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.01.2022.

46. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

47. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“I. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral. ”.

48. Duke iu referuar rezultateve të verifikimit të paraqitura më sipër, KED arrin në përfundimin se kandidatja Mariana Semini (Tutulani) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit që lidhen me shtetësinë, zotësinë për të vepruar, arsimin, përvojës profesionale, integritetin dhe pasurinë.

49. Në zbatim të nenit 67 të Vendimit Nr.4, datë 11.03.2019 të KED, ka shqyrtuar rezultatet e kontrollit të kryer nga ILDKPKI në lidhje me verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë të të dhënave që përmbahen në Deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit është konkluduar se rezultati i arritur është rrjedhojë e një kontrolli dhe analize financiare të plotë të deklaramëve të bëra nga kandidati, të vlerësuara dhe me të dhënat e marra nga subjekte juridike publike dhe private, të dhëna të marra kryesisht nga ana e ILDKPKI, duke mos u vlerësuar e nevojshme marrja e informacioneve shtesë nga ky institucion në lidhje me konkluzionet e arritura.

50. Rezulton e provuar se paditësja është subjekt i deklaramit DIVA, ajo ka plotësuar Deklaratat Individuale Vjetore të Ardhurave për periudhën 2011-2022, duke shlyer/paguar detyrimet tatimore të gjeneruara nga sistemi elektronik i tatimeve. Janë administruar provat që kandidatja ka depozituar në KED, aktet që i përkasin procedurës administrative të filluar me kërkesë të saj nga organi tatimor, DRT Tiranë. Organi tatimor i ka nënshtruar kontrollit tatimor deklaramat DIVA të kandidatës, me kërkesë të kësaj të fundit, për të rregulluar pasaktësitë e bëra në deklaramet vjetore. Në përfundim të kontrollit të ushtruar nga ana e DRT Tiranë janë nxjerrë tre akte njoftim vlerësimi për detyrimet, të cilat janë kundërshtuar nga ana e saj në rrugën administrative të ankimit pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor. Kjo e fundit ka marrë Vendimin Nr.1485/4, 1534/2, datë 11.10.2022 me të cilin ka shqyrtuar aktet objekt ankimi në themel të tyre, duke gjetur pjesërisht të mbështetura pretendimet e paditëses. Për efekt të ankimit administrativ, kandidatja ka përmbushur detyrimin e parapagimit të detyrimit tatimor, duke mos patur detyrime tatimore të papaguara.

51. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, KED vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës Marian Semini (Tutulani), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.01.2022.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 78 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatës Mariana Semini(Tutulani), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.01.2022.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Mariana Semini (Tutulani).
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR

Sokol BINAJ



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Sokol Binaj', written over a circular official stamp. The stamp is blue and contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top, 'KESHILLI I EMERIMEVE NE DREJTESI' around the inner edge, and 'TIRANE' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302